



**VENDIM**

*Nr. 42 Datë 29.04.2013*

**MBI**

**TRANSFERIMIN E AKSIONERIT QE KONTROLLON  
INTERESAT E SHOQËRISE “HEC BISTRICA 1 DHE BISTRICA 2”  
SH.A, NGA MINISTERIA E EKONOMISË, TREGTISË DHE  
ENERGJETIKES TEK “KURUM INTËRNATIONAL” SH.A**

Në mbështetje të nenit 9 të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, Ligjit nr. 93/2013, datë 4.03.2013 “Për ratifikimin e kontrates për shitjen e 100 % të aksioneve të shoqërisë HEC Bistrica 1 dhe Bistrica 2 sh.a të lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe shoqërisë Kurum International”, VKM nr. 26, datë 9.01.2013 “Për miratimin e raportit përfundimtar të vlerësimit të ofertave dhe të kandidatit fitues për privatizimin e shoqërisë “Hec Bistrica 1 dhe Bistrica 2” sh.a ”, pikës 6.2 të Licensës së Prodhimit të Energjisë Elektrike, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 29.04.2013, mbasi shqyrtoi kërkesën e Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe aplikimit të shoqërisë HEC Bistrica 1 dhe Bistrica 2 , për transferimin e aksionerit që kontrollon interesat e shoqërisë HEC Bistrica 1 dhe Bistrica 2 sh.a nga METE tek “Kurum International” sh.a dhe informacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

**Vendosi:**

1. Të miratojë transferimin e aksionerit që kontrollon interesin e shoqërisë “Hec Bistrica 1 dhe Bistrica 2” sh.a. nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, tek “Kurum International” sh.a.
2. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Sokol RAMADANI**

**Ne mungese dhe me porosi**

**Entela SHEHAJ**

